Ditari Natyrës

Nr. 34 Viti i katërt i botimit Mars 2016

INCA INSTITUTE FOR NATURE CONSERVATION IN ALBANIA

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- 2 Shkurti, Dita Botërore e Ligatinave, EJA DHE TI !
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se 16 vjet më parë ...

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.82, **datë 02.03.2000** shpallet Park Kombëtar, në mbrojtje të shtetit, zona arkeologjike e Butrintit, me sipërfaqe 25 km2.

Bazuar në rekomandimet e disa studime të kryera për këtë territor, kompleksi natyror ligatinor i Liqenit të Butrintit dhe rrethinat e tij, përfshi edhe kepin e Stillos, me VKM nr.693, datë 10.11.2005, u rishpall Park Kombëtar, me sipërfaqe të zgjeruar prej 8,591.2 ha.

Në kuadrin e projektit të Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare (ICZMCP), u hartua dhe plani i menaxhimit të PK të Butrintit, i cili u miratua, sipas dispozitave të ligjit "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, me urdhrin nr.404, datë 09.06.2011 të ministrit të Mjedisit. Mbi bazën e rekomandimeve të planit të menaxhimit, me VKM nr.134, datë

Vijon në faqe 2

Parku Kombëtar i Butrintit © N.Dragoti/INCA

Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës

RRJETI PËR MBROJTJEN E NATYRËS · Adriatiku · GreenClean · PSEDA - ILIRIA · SHOQATA MJEDISORE CAJUPI Bashkejeto me Natyrën

Vijon nga faqe 1

20.02.2013, sipërfaqja e parkut u zgjeruar në 9,424.4 ha, nga e cila 883.2 ha është zonë detare.

Territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (ku u përfshinë Liqeni i Butrintit, zona arkeologjike e PK të Butrintit, Kepi i Stillos dhe ishujt e Ksamilit), me sipërfaqe të përgjithshme prej 13,500 ha, me VKM nr.531, datë 31.10.2002, shpallet zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, për t'u përfshirë në listën e Konventës (Ramsar) "Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë"...

...7 vjet më parë ...

...Me VKM nr.241, **datë 06.03.2009** miratohet "Lista e llojeve të huaja invazive dhe për përcaktimin e proçedurave, për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit". Sipas këtij vendimi...Ndalohet futja në territorin e Republikës së Shqipërisë të llojeve të huaja invazive, sipas përcaktimit të shtojcës I... Ndalimin e futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të ekzemplarëve të rinj, të llojeve të huaja, me shkallë invazioni 3, sipas shtojcës II...Lejimin ose ndalimin, për rastet e tjera, të një lloji të huaj, për t'u importuar ose për t'u introduktuar në territorin e vendit tonë, mbështetur në vlerësimin e rrezikut, që mbart importimi ose introduktimi i tij, i cili vlerëson shkallën e invazionit të llojit të huaj....Vlerësimi i rrezikut të një lloji të hua është vlerësimi i pasojave të introduktimit dhe mundësisë së instalimit të njëlloji të huaj, duke përdorur informacionin shkencor. Menaxhimi i rrezikut përcakton masat, që duhen zbatuar për t'i reduktuar ose menaxhuar rreziqet e identifikuara gjatë vlerësimit të rrezikut... Mos lejimin, nga administrata doganore, e futjes, në territorin doganor, të llojeve të huaja, kur subjektet nuk janë të pajisura me leje....etj...

...6 vjet më parë ...

...Miratohet Ligji nr.10253, **datë 11.03.2010** "Për gjuetinë". Ky ligj ka për qëllim: a) përcaktimin e rregullave e të kërkesave për zhvillimin e gjuetisë, si një veprimtar tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike; b) menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj; c) garantimin që parimet për gjuetinë të zbatohen në mënyrë rigoroze, duke ruajtur tërësinë e ekosistemit dhe baraspeshën ekologjike; ç) mosdëmtimin e llojeve të faunës së egër e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të gjuetisë; d) respektimin e së drejtës së gjuetisë dhe të të drejtave mbi gjahun, mbi trofetë e produktet e gjuetisë dhe të tregtimit të tyre...

Me ligjin nr.7/2014 "Shpallet Moratoriumi i Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i ligjit është përmirësimi i gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie. Ndërsa objekti i tij është ndalimi i ushtrimit të gjuetisë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Aktualisht po organizohen dëgjesa me publikun nga MM, për shtyrjen e këtij moratoriumi edhe për 5 vite të tjera.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administata e Zonës së Mbrojtur, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrinë masa për kremtimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqetë re nëpunën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

2 Shkurti, Dita Botërore e Ligatinave, EJA DHE TI !

Një pikënisje e ndërgjegjësimit mjedisor pranë Peizazhit Ujor-Tokësor i mbrojtur Lumi Buna-Velipojë.

2 Shkurti i shpallur si "Dita Botërore e Ligatinave" është bërë një festë mjedisore tradicionale e çdo viti. Kjo ditë shënon datën e miratimit të Konventës për Ligatinat në 2 Shkurt 1971 në qytetin Iranian të Ramsar-it prej të cilit kjo konventë ka marrë dhe emrin. Zonat ligatinore në vetvete janë vlera të natyrës dhe biodiversitetit të vendit, që njihen në një plan më të gjerë ndërkombëtar, dhe që shtojnë interesat për zhvillimin e aktiviteteve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Vetë Konventa e Ramsarit i sheh vlerat natyrore të lidhura ngushtë me aspektet socio-ekonomike të popullsisë që jeton në to ose në afërsi të tyre.

Nëpërmejet Ditës Botërore të Ligatinave ofrohet çdo vit një mundësi e mirë për të reaguar e kërkuar ndryshimin e situatës dhe ndërgjegjësuar publikun mbi rëndësinë që kanë ligatinat në të ardhmen e njerëzimit. Çdo vit Sekretariati i Konventës së Ramsarit përzgjedh një temë specifike që demostron rolin vital të ligatinave për të ardhmen e njerëzimit. Sllogani i këtij viti "*Ligatinat e së ardhmes një mirëqenie e qëndrueshme për njerëzimin*" tingëllon aktual megjithëse, gjysma e ligatinave në botë janë zhdukur gjatë shekullit të fundit. Ligatinat ose e thënë ndryshe sistemet e "tokave të lagura", janë sipërfaqe ujore të përhershme ose përkohshme deri në 6 metra thellësi, dhe përbëjnë një ekosistem mjaft të rëndësishëm që siguron larmi shërbimesh përfshirë filtrimin e ujit, sigurimin e biodiversitetit, mbrojtjen e bregdetit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike. Këto shërbime të rëndësishme që ofrojnë ligatinat njihen shumë pak nga komuniteti i gjerë.

Pak kush e di se në vendin tonë, 3% sipërfaqes së tokave të lagura në bregdet,

Vijon në faqe 4

Vijon nga faqe 3

strehojnë 75% e vlerave të biodiversitetit. Kjo është pjesë e ndërgjegjësimit të tyre dhe në jo pak raste, ligatinat janë shndërruar në vende për hedhjen e mbeturinave apo janë transformuar në toka buke apo terrene ndërtimi duke i tjetërsuar vlerat dhe natyrën e tyre.

Për të përçuar me tej mesazhin e Ditës Botërore të ligatinave, më 2 Shkurt 2016, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri, (INCA) dhe Qendra AARHUS Shkodër në bashkëpunim me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Shkodër, si dhe me mbështetjen e IUCN dhe Zyrës së Bashkëpunimit Italian, organizuan një event një ditor për të promovuar Peizazhin Ujor/Tokësor të mbrojtur të lumit Buna dhe territoreve ligatinore përreth tij, si një zonë veçanërisht e mbrojtur dhe e përfshirë në listën e Konventës Ramsar, si një zonë me potenciale të larta natyrore, ekonomike, kulturore dhe historike dhe me rëndësi të veçantë në nivel ndërkombëtar.

Aktivitetit pati për qëllim të tërhiqte dhe nxiste vëmendjen e vendimmarresve të sotëm dhe të ardhshëm për mbrojtjen dhe zhvillimin e kësaj zone, si dhe të krijonte bazat e një bashkëpunimi me të mirë mes komunitetit përreth dhe autoriteteve përgjegjëse lokale mjedisore dhe qeverisjes vendore. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm nxënës, mësues dhe prinder nga 6 shkolla 9-vjeçare përreth zonës ligatinore, përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, nën kryetari i Bashkisë Shkodër, Kryetari i Njësisë Administarive Velipojë, përfaqësues nga Inspektorati i Pyjeve dhe Mjedisit Shkodër, Universitetit Shkodër, ARM Shkodër, shoqërisë civile, banorë të zonës, etj. Aktiviteti u shoqërua me një vizitë në zonën ligatinore si dhe me një ekspozitë punimesh më të mira të nxënësve të shkollave.

Festimi i Dites Botërore të Ligatinave pranë një zone të mbrojtur ligatinore, shërbeu si një ditë refleksioni për edukimin mjedisor dhe si

një vazhdimësi e zinxhirit të aktiviteteve të përbashkëta që INCA dhe Qendra Aarhus Shkoder ka ndërmarrë dhe do të zhvillojë më tej në bashkëpunim

Vijon në faqe 5

Vijon nga faqe 4

me stafin e zonës së mbrojtur dhe 6 shkollat 9-vjeçare në territorin përreth zonës së mbrojtur ligatinore. Një vend të rëndësishëm në këtë event zuri promovimi i vlerave natyrore të zonës së mbrojtur nëpërmjet krijimeve artistike të fëmijëve, të frymëzuar nga ekskursionet mësimore të zhvilluara dy muaj më parë, ku në bashkëpunim me punonjësit e AdZM-Shkodër vetë nxënësit eksploruan zonën e mbrojtur dhe luajtën rolin e renxherit duke inspektuar dhe u kujdesur ata vetë për natyrën e saj.

Krijimet artisitke të femijeve varinonin nga poezi e piktura deri në makete të mrekullueshme të realizura bukur e me një talent të spikatur ashtu sikuse vetëm çiltërsia e fëmijëve mund ti krijojë. Punimet e tyre ishin shoqëruar jo pak here edhe me mesazhet ndërgjgjësuese që ata vetë shpërnadanin për bashkëmoshatarët, por pse jo edhe për ne më të rriturit që sot kemi në dorë mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit që na rrethon e që do të duhet ta trashëgojmë të shëndetshëm për fëmijët tanë e për brezat e së ardhmes.

Pikërisht këto mesazhe të fëmijëve si vendimmarrësit e të ardhmes dhe influenca e tyre tek më të rriturit lidhur me sjelljen dhe përqasjen ndaj përdorimit dhe promovimit të pasurive të natyrës, ishin mesazhi kryesor që ky event transmetoi tek të pranishmit. Për punimet më të mira u ndanë çmimet e mirënjohjes dhe të gjithë nxënësit pjesëmarrës u paisën me nga një çertifikatë me titullin "Mik i Natyrës".

Krijimtaria dhe reagimet e nxënësve të shkollave ishin më shumë se mbresëlënëse dhe dhuruan emocione dhe sadisfaksion për të gjithë të pranishmit. Premtimi i një udhëtimi në një nga zonat ligationre më me fame kombëtare dhe ndërkombëtare siç është Parku Kombëtar Divjakë -Karavsta si një trofe i merituar nga të gjithë nxënësit pjesëmarrës, ja shtoi edhe më tepër buzëqeshjet këtij eventi.

Ne dhe Natyra

(Ese për natyrën nga Floriana Ujka, nxënëse e klasës IX, Shkolla Gjergj Vat Martini, Velipojë)

Në moshë të vogël unë nuk doja t'ia dija për pyjet, pemët, gjelberimin e me rradhe. I dëmtoja pa asnjë arsye. Duke u rritur pak nga pak e kuptova gabimin fatal që kisha bërë. Ndonjëherë mendoj me vete:

– Të dëmtoj një pemë?? E pamundur !! Si mund të dëmtoj atë që më mban në jetë, që më jep ajër, oksigjen, që bën të mundur frymëmarrjen time?! Është njësoj si të kafshosh dorën me të cilën po ushqehesh. Nga ana tjetër pemët mund të jenë shtëpia e dikujt.

Për shëmbull: në Rezervatin e Velipojës para shumë kohësh njerëzit kanë bërë gjueti pa kriter, duke vrarë gjallesa nga më të ndryshmet. Por kjo nuk u mjaftoi! Ata shkatërruan pyllin duke prerë pothuajse të gjitha pemët. Tani ata kanë ardhur duke u ndërgjegjësuar sepse rezervati i Velipojës u shpall "Zonë e Mbrojtur". Rezervati ka ndryshuar krejtësisht. Tani sapo hyn në pyll dëgjon cicërimat e ëmbla të zogjve të ndërthurura bukur me shushuritjet e gjetheve. Mberesëlenëse! Është bukur të shohësh qiellin e kaltërt të mbushet me shpende unik në llojin e tyre pikërisht në Velipojë. Disa prej tyre janë rosa, karabullaku, mëllenja etj. Prandaj për të mos i çuar dëm këto pasuri natyrore eja ti themi sëbashku: **STOP GJUETISË! STOP DEMTIMIT TË PYJEVE !**

Pemë moj fisnikja pemë

Poezi

Mes lëndinash lule rrethuar
male të thepisura të shikojnë nurin
me aromë të ëmbël nën duar
hije lulesh bën dhe gurin

Mes erës të valëviten degët
shpirti duron shi e borë
në ditët e pranverës
me ngjan si nuse me kurorë

Në mesditën e zheguar
në ditët e Korrikut të zjarrtë
lëshoj trupin për të pushuar
dielli mbi kokën tënde shtrihet i artë



Me shumë mall afrohet edhe vjeshta
ajo e arta bashkë me frutat e tua
stinë më stinë sa njëra te tjetra
më falin bekimin mua

Në syçkat e mia ngjan shumë e madhe
si pëllumbeshë gem me gem
në melodinë e gjethes tënde
pemë moj finikja pemë.....!

NJOFTIME

21 Mars - Dita e Ndërkombëtare e Pyjeve
22 Mars - Dita Botërore e Ujit
23 Mars - Dita Botërore e Meteorologjisë
28 Mars - Dita e Tokës

1 - JOB ANNOUNCEMENT, Dinaric Arc Programme Policy Officer, Albania
http://www.inca-al.org/index.php/sq/item/457-job-announcement-dinaric-arc-programme-policy-officer-albania

2 - Raporti i plotë studimor rreth vlerësimit të cilësisë së studimeve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve të hidrocentraleve në Evropen Juglidore.
http://d2ouvy59p0dg6k.cloudfront.net/downloads/hidro_v6_webr.pdf

3 - Rrugëtimi drejt Parisit 2015 - për integrimin e çështjeve të NK në politikat dhe dokumentet strategjike të vendit.
http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=item&id=438:rrugetimi-drejt-parisit-2015&Itemid=133&lang=sq

4 - Për të lexuar **"*Ditari i Natyrës*"** në vite…
http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=15&Itemid=195&lang=sq

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.
Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, 1001, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania